

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“VIRTUAL ASSISTANTS GROUP” SHPK

Sot, më datë 30.05.2024 (Dymijë e njëzet e katër), ortakut themelues:

1. **Z. Afrim Bunjaku** -shtetas kosovar, lindur në Pakashticë e Epërme, i datëlindjes 14.03.1980, me banim në Prishtinë: i identifikuar me Nr. Personal 2030925737.

Ka vendosur themelimin e shoqërisë “Virtual Assistants Group” shpk me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Virtual Assistants Group” shpk themelohet në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, (këtu e më poshtë Shoqëria). Shoqëria është një person juridik Shqiptar.

NENI 2. Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria është Person Juridik Privat. Shoqëria do te paraqitet në qarkullimin juridik-civil me emërtimin e saj “**Virtual Assistants Group**” SHPK.

NENI 3. Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do te kryej aktivitetin e mëposhtem:
Shitje produktesh industriale,dhe softwerike, shërbime të mirmbajtjes informatike, si dhe çdo lloj aktiviteti tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4 Selia e Shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: - Rruga Idriz Dollaku, Pallati DOMUS, Hyrja 1, Ap.22, Tirane.

4.2 Adresa e selise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakut te Shoqerise.

NENI 5. Kapitali i Shoqërisë

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie në lekë.

Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 100,000 (njëqindmijë) Lekë, i ndarë në **1(një)** kuota .

Ortakët themelues të shoqërisë, i zotërojnë kuotat në shoqëri si më poshtë:

- **Afrim Bunjaku** – Zotërues i 1(një) kuote që përfaqson 100% te kapitalit të shoqërisë me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Kapitali themeltar është derdhur tërësisht nga ortaku themelues. Vlera dhe pagesa e e kapitalit themeltar do të kryhet në momentin e nënshkrimit të këtij statuti dhe aktit të themelimit.

NENI 6. Kohëzgjatja e shoqërisë

VIRTUAL ASSISTANTS GROUP
AKT THEMELIMI

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj ekonomik për një afat të pacaktuar.

Neni 7. Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakut - organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administator i pare i shoqërisë do të jetë Znj, Ana Xhepa - shtetase shqiptar, e bija e Naimit, lindur në Tirane, i datelindjes 22.01.1996 me banim në adresen: Rruga Llambi Bonata Nd. 1859; H.1; Ap.6; Tirane , mbajtëse e leternjofimit me nr. personal J65122041N me një mandat 5 (pesë) vjeçar.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Eksperti Kontabël i Autorizuar i shoqërisë do të emërohet në përputhje me me legjislacionin përkatës në fuqi dhe për çdo vit financiar shoqëria do të emërojë një ekspert kontabël për të kontrolluar aktivitetin ekonomik të shoqërisë.

NENI 9

Ortaku themelues mund të vendosi me vullnetin e tij, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortaku detyrohet të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12. Legjislacioni i aplikuar

VIRTUAL ASSISTANTS GROUP
AKT THEMELIMI

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga Statuti i firmosur nga ortakut themelues dhe i vulosur përpara noterit, në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

NENI 13. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakut apo ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14. Dispozita Përfundimtare

Akti i themelimit përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

1. Afrim BUNJAKU

A handwritten signature in blue ink, reading "Afrim Bunjaku", is written above a horizontal line. Below the line is a large, stylized flourish or scribble, also in blue ink.